



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:333735

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06726834

P.nr.358/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit P.J. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale *Mospërfillja e gjykatës* nga neni 393 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm, PP.II.nr.1900/22 e datës 21.11.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar e publik të mbajtur me datë 15.01.2025, në të cilin seancë ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Albana Parduzy, i pandehuri P.J., e dëmtuara E.K. dhe mbrojtësi i viktimave Muhamet Përvetica, më datë 15.01.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: P.J. nga i ati A..., e ëma M..., e gjinisë K..., data e lindjes... në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, tani me vendbanim në Vushtrri rr. "...", me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon në ndërtimtari në kompaninë F. B., i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë 16.09.2022, rreth orës 23:00 minuta, në Vushtrri në rrugën "...", saktësisht në banesën e përbashkët, nuk i bindet Aktvendimit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil C.nr.212/22 i datës 27.05.2022 i cili është valid në kohëzgjatje prej 12 muajve, ku është aprovuar kërkesa e palës së dëmtuar E.K., ashtu që i pandehuri ndalohet që të ushtroj çfarëdo dhune, kërcënimi, shqetësimi, keqtrajtimi, kanosje, sulmi apo çfarëdo forme tjetër si ndaj të dëmtuar ashtu edhe ndaj personave tjetër me të cilët pala e dëmtuar ka lidhje familjare dhe jeton në një shtëpi të përbashkët, ti shkaktoj dhunë fizike apo psikike që hynë në kuadër të dhunës në familje,

mirëpo pavarësisht kësaj i pandehuri nuk i bindet urdhrit të gjykatës dhe me datë 16.09.2022, pas një mosmarrëveshje e kap për flokëve dhe e sulmon duke e goditur grushte në pjesën e majtë të kokës,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së,
e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: P.J. i shqipton DËNIM MË GJOBË në shumën prej pesëqind (500) euro i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në rast se i akuzuari refuzon ose nuk mund të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akzuarit për çdo 20 euro (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar E.K.ka heq dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PPII.nr.1900/22 e datës 21.11.2024, kundër të pandehurit P.J. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 15.01.2025, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri P.J. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, i premtun gjykatës që në të ardhmen kjo vepër dhe veprat e tjera nuk do të përsëriten më dhe shton se njëherit i kërkon falje të dëmtuarës dhe se me të njëjtën tani më janë pajtuar.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se është e pajtimit me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë si dhe i propozon gjykatës që pranimin e fajësisë ta

aprovoj, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese dhe rënduese ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë asaj që është propozuar në aktakuzës.

Mbrojtësi i viktimave lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe i ka propozuar gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta miratoj.

Pala e dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, heq dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike dhe shton se tani më raportet në mes tyre janë përmirësuar.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-BD-868, i datës 17.09.2022, raporti i oficerit, i datës 17.09.2022, raporti ditor i dhunës në familje, i datës 16.09.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin P.J., i datës 17.09.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për ankuesin E.K., i datës 16.09.2022, si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose ndonjë gabim faktik.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri P.J. ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 393 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mospërfillja e gjykatës e kryen “*Kushdo që nuk i bindet ndonjë urdhri, vendimi apo aktgjykimi të plotfuqishëm të ndonjë gjykate në Republikën e Kosovës ose refuzon apo pengon publikimin e vendimit apo aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës së tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin P.J. ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin

e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale dhe rrethanat personale të tij, përkatësisht faktin se i njëjti është prind i tre fëmijëve dhe mbajtës i familjes, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit, respektivisht të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë gjë që është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykim P.nr.477/18 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri, i plotfuqishëm me datë 02.11.2018 për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik dhe aktgjykimin P.nr.245/22 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri, i plotfuqishëm me datë 15.02.2023 për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor, si dhe faktin se kjo vepër penale është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.”*. Kjo pasi që në seancën e shqyrtimit fillestar pala e dëmtuar E.K. ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal P.nr.358/2024,
datë 20.01.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

Numri i lëndës: 2024:333735
Datë: 20.01.2025
Numri i dokumentit: 06726834

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.